



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe nenit 21, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018 për Marrëdhënie Pune, Zyra Kombëtare e Auditimit, me datën 22.05.2020, publikon këtë:

SHPLLJE **për Angazhim në Punë dhe Detyra Specifike**

I. Angazhim për shërbime: Tre (3) Auditor Junior për auditimin e rregullsisë

Numri i referencës: AJ/ZKA/11-05/20

Qëllimi i punës:

Pozita Auditor Junior mbulon detyra profesionale me mbikëqyrje dhe udhëzime të herë pas herë nga udhëheqësi..

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga Udhëheqësi i Ekipit (nën mbikëqyrje);
- Përfitimi i njohurive të plota rreth institucioneve të audituara dhe kuptueshmëri të plotë të çështjeve, prioriteteve dhe rreziqet që i ballafaqojnë ato (pako për njohjen e punës);
- Ndhmon Udhëheqësin e Ekipit në planifikim të auditimit në çështje të caktuara;
- Shfrytëzimi i teknikave të sakta analitike dhe gjykimet për të arritur në konkluzione të qëndrueshme në bazë të dëshmitë të mbledhura;
- Dhënia e konkluzioneve të sakta në bazë të gjykimit profesional duke u mbështetur në dëshmitë të mbledhura;
- Përgatitja e Letrave të Punës (memo përmbledhëse) lidhur me auditimin e komponentës apo fushës audituese, e cila i është caktuar;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga mbikëqyrësi.

Përshkrimin e detyrave, së bashku me këtë shpallje e gjeni në faqen e internetit të ZKA-së “Mundësi Punësimi”.

Mënyra dhe periudha e angazhimit për shërbime në punë dhe detyra specifike:

Angazhimi i auditorëve junior bëhet me kontratë për punë dhe detyra specifike për një periudhë të caktuar kohore prej tre (3) muajve. Angazhimi në punë planifikohet të bëhet në fillim të muajit qershor. Planifikimi për fillimin e angazhimit në kryerjen e detyrave mund të ndikohet varësisht prej rrethanave të situatës pandemike.

Për shërbimet e kryera, kompensimi bëhet në lartësinë e caktuar me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit për nivelin e pozitës “Auditor Junior”

Kushtet themelore për angazhimin në punë dhe detyra specifike:

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Diplomë fakulteti;
- Të jetë i certifikuar në njëren prej skemave të certifikimit për teknik kontabiliteti apo kontabilist.
- Të kenë përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa apo administratë publike, së paku prej 3 viteve.

Kandidatët të cilët kanë kualifikime më të larta në skemat e certifikimit profesional kanë përparësi.

Mënyra e konkurimit:

Kandidatët e interesuar, aplikacionin zyrtar mund ta marrin në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit apo ta shkarkojnë nga ueb faqja e internetit në adresën: <http://www.zka-rks.org/> dhe mund të paraqesin dokumentacionin në kopje fizike në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në adresën: rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210- Prishtinë apo të aplikojnë përmes faqes së internetit në adresën: rekrutimi@oagks.org.

Kandidatët, aplikacionit duhet bashkëngjitur:

- dëshmitë për kualifikimin shkollor;
- dëshmitë për kryerjen e skemave të certifikimit në kontabilitet;
- dëshmitë për përvojën e punës;
- kopjen e letërnjoftimit.

Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara me këtë Shpallje, nuk do të shqyrtohet.

Shpallja është e hapur tre (3) ditë, nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në gazetën online: Koha Ditore” me datën 23.05.2020 dhe mbetet e hapur deri më datën 26.05.2020. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin për Burime Njerëzore, në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.